



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më 30.07.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN E MOSNDARJES SË PROÇEDURËS SË PROKURIMIT NË
LOTE**

OBJEKTI I PROCEDURËS: ‘Depozitim i mbetjeve urbane ne landfill te mbetjeve urbane te Bashkise Kruje ‘.

**LLOJI I PROCEDURES:PROCEDURE E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTE
MONETAR**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
90530000-1 - Menaxhimi i një vendi depozitimi mbeturinash

VLERA E FONDIT LIMIT: 57’112’020 (pesedhjet e shtate milion e njeqind e dymbedhjeta mije e njezet) lekë pa tvsh

Vlera e fondit limit/e konvertuar sipas monedhes Euro referuar publikimit te kursit te kembimit zyrtar te Bankes se Shqiperise ,eshte= 609’780.2 (gjashteqind e nente mije e shtateqind e tetedhjeta presje dy)euro pa T.V.SH

- *Kursi i kembimit sipas Bankes se Shqiperise ne **daten 04.08.2026**, eshte **1Euro = 93.66 lek***

BURIMI I FINANCIMIT: Te ardhurat e Bashkise Kruje te miratuar me VKB nr 68 date 26.12.2025 ‘Per Miratimin e Buxhetit te Vitit 2026’.

Sot me date 28.07.2025 , ne Bashkine Kruje ne Zyren e Sektorit te Prokurimit Publik Bashkia Kruje mbahet ky procesverbal mbahet ne mbështetje të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 42, pikat 1 dhe 2 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,të ndryshuar, nga ana e (AK) Bashkia Krujë, Njësia e prokurimit për objektin: **“Depozitim i mbetjeve urbane ne landfill te**

mbetjeve urbane te Bashkise Kruje ‘, mbi argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Bazuar në VKM-në Nr. 291, datë 15.5.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik” si dhe në VKB-në Nr. 68 , datë 26.12.2026 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2026 ‘, vihet re se buxheti i akorduar për këtë objekt prokurimi në total për 12 muaj është **57’112’020** (pesedhjet e shtate milion e njeqind e dymbedhjetë mijë e njezet) lekë pa tvsh pra shuma e tille e preventivuar rezulton te jete mbi kufirin e larte monetar, mbështetur në gërmën b), të pikës 1, në Kreun II “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” të VKM-së së mësipërme citojmë se: “1. **Kufiri i lartë monetar** në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: b) Për procedurat e prokurimit për mallra, **shërbime** dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.”

Gjithashtu në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht:

“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Ndodhur në këto kushte ,njësia e prokurimit argumenton se:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimit, specifikimeve teknike dhe raportit teknik Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçanta, pasi depozitimi I mbetjeve urbane ka efektivitet vetem ne nje kontrate sepse është shumë e vështirë teknikisht eshte e veshtire për tu menaxhuar.ne disa kontrata.

Nga ana tjetër argumentojmë se kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik . Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës, por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës, që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion, depozitimi i mbetjeve urbane janë procese të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, dhe ndarja e tyre në dy ose me shume lote do të sillte çrregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK-në.

Ne konkluzion Njesia prokurimit vendosi te mos e ndaje kete objekt prokurimi me lote :

Për të gjitha arsyet e cituara më sipër:

Ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

NJËSIA E PROKURIMIT